



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONI RREGULLATOR

Tiranë më

4.3.2025

Nr. Prot.

1562

**Lënda:** Kërkesë për vetëmbledhjen e Komisionit Rregullator, për shqyrtimin e projektaktit “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 10, datë 23.10.2024 “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve”.

**Drejtuar:** Komisionit Rregullator

Z.Illirjan Celibashi  
Komisioner Shtetëror i Zgjedhjeve

Të nderuar Anëtarë të Komisionit Rregullator,

I nderuar Komisioner Shtetëror i Zgjedhjeve,

Me vendimin nr. 10, datë 23.12.2020, Komisioni Rregullator ka miratuar rregullat për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve.

Neni 12, pika 4 e Kodit Zgjedhor përcakton se Komisioni Rregullator (Rregullatori) është organi kompetent për miratimin e akteve me karakter normativ në fushën e zgjedhjeve dhe vendosjen e rregullave për zgjedhjet.

Po në nenin 12 pika 4 të Kodit Zgjedhor parashikohet se: “Në rast se Komisioneri nuk vë në lëvizje Rregullatorin kur ka çështje të kompetencës së tyre, atëherë organet vetëmbledhen me kërkesë të çdo anëtari”.

Neni 20, pika 1, shkronja “dh” e Kodit Zgjedhor, parashikon kompetencën e Komisionit Rregullator për miratimin e projektaktit për rregullat për regjistrimin e votuesve nga jashtë vendit, për procedurat e tyre të votimit, për administrimin dhe numërimin e votave nga jashtë vendit dhe përfshirjen e tyre në rezultatin e përgjithshëm të zgjedhjeve për Kuvendin.

Në nenin 24, pika 5 të Kodit zgjedhor përcaktohet se: “Procedurat e detajuara të votimit nga jashtë vendit miratohen me akt normativ të Rregullatorit, me propozimin e Komisionerit, brenda 90 ditësh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji”.

Rruga “Ibrahim Rugova”, Nr. 1, Tiranë, Shqipëri |



| info@kqz.gov.ai | kqz.gov.ai | +355 4 7510810

Në nenin 25, pika 1 dhe 12, parashikohet se: “Zgjedhësi që ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe që dëshiron të ushtrojë të drejtën e votës për zgjedhjet e radhës për Kuvendin duhet të regjistrohet në listën e zgjedhësve jashtë vendit, në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë Kod dhe aktet nënligjore në zbatim të tij”, si dhe parashikon gjithashtu kompetencën e Komisionit Rregullator për miratimin e akteve të nevojshme normative nënligjore për përbërësit e listës së zgjedhësve jashtë vendit, dokumentacionin e nevojshëm për aplikim, mënyrën dhe atëtet e komunikimit me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile dhe eventualisht bazë tjetër të dhënash, si dhe modalitetet dhe rregullat e tjera teknike të hartimit të kësaj liste.

Po në nenin 25, pika 4 të Kodit zgjedhor parashikohet se: “Regjistrimi i zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë realizohet nga KOZ-ja. Procesi i hartimit të listës së këtyre zgjedhësve fillon 120 ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 60 ditë para kësaj date. Hapja e procesit të hartimit të listës së zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë njoftohet publikisht nga Komisioneri Shtetëror për Zgjedhjet”.

Ndërsa pika 7 e nenit 25 përcakton se: “Komisioneri Shtetëror për Zgjedhjet, 63 ditë përpara datës së zgjedhjeve, publikon listën paraprake të zgjedhësve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim që zgjedhësit brenda 48 orësh nga publikimi i saj të mund të kërkojnë regjistrimin apo rregullimin e pasaktësive të regjistrimit të tyre. Komisioneri Shtetëror për Zgjedhjet, 60 ditë para datës së zgjedhjeve, miraton dhe publikon në faqen zyrtare të internetit të KOZ-së listën përfundimtare të zgjedhësve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Lista e zgjedhësve pas përfundimit të procesit nuk ndryshon në asnjë rrethanë dhe për asnjë shkak pas afatit të parashikuar në këtë pikë, me përjashtim të rastit të parashikuar në pikën 8 të këtij neni”.

Neni 46, pika 3 e Kodit Zgjedhor, parashikojnë se: Lista e zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit përfshin vetëm zgjedhësit me vendbanim jashtë vendit, të cilët deklarojnë vullnetin për të ushtruar të drejtën e votimit, sipas rregullave të dala në zbatim të nenit 24 të Kodit Zgjedhor.


Nisur nga sa më sipër dhe në përputhje me nenin 11 pika 6 dhe nenin 16 të “Rregullores Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit Rregullator”, po ju paraqesim këtë kërkesë, për vetëmbledhjen sa më parë të Komisionit Rregullator, me qëllim shqyrtimin e projekt aktit me objekt “Për disa shtesa në Vendimin nr. 10, datë 23.10.2024 “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR REGJISTRIMIN E ZGJEDHËSVE NGA JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE PËRGATITJEN E LISTËS SË ZGJEDHËSVE, TE NDRYSHUAR”. Sjellim në vëmendjen tuaj afatin e ngushtë të mbetur ndaj kërkojmë mirëkuptimin që kjo mbledhje të thirret me urgjencë, brenda ditës së sotme më 4 Mars 2025.

**Helga VUKAJ**

Anëtar i Komisionit Rregullator

**Muharrem ÇAKAJ**

Anëtar i Komisionit Rregullator





KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONI RREGULLATOR

Data  
Nr. Prot

RELACION  
PËR  
PROJEKTVENDIMIN

PËR

DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 10, DATË 23.10.2024 "PËR MIRATIMIN E  
RREGULLAVE PËR REGJISTRIMIN E ZGJEDHËSVE NGA JASHTË  
TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE PËRGATITJEN E  
LISTËS SË ZGJEDHËSVE"

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË  
FUQI

Në mbështetje të nenit 12 pika 4, nenit 20 pika 1, shkronja "dh", nenit 24 pika 5, nenit 25 pikat 1 dhe 12, nenit 46 pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e një anëtari të Komisionit Rregullator, Komisioni Rregullator vihet në lëvizje si organi kompetent për shqyrtimin dhe miratimin e projektakteve me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ose nga anëtarët e tij.

Neni 12, pika 4 e Kodit Zgjedhor përcakton se Komisioni Rregullator (Rregullatori) është organi kompetent për miratimin e akteve me karakter normativ në fushën e zgjedhjeve dhe vendosjen e rregullave për zgjedhjet.


Po në nenin 12 pika 4 të Kodit Zgjedhor parashikohet se: "Në rast se Komisioneri nuk vë në lëvizje Rregullatorin kur ka çështje të kompetencës së tyre, atëherë organet vetëmblihen me kërkesë të çdo anëtari".


Neni 20, pika 1, shkronja "dh" e Kodit Zgjedhor, parashikon kompetencën e Komisionit Rregullator për miratimin e projektaktit për rregullat për regjistrimin e votuesve nga jashtë vendit, për procedurat e tyre të votimit, për administrimin dhe numërimin e votave nga jashtë vendit dhe përfshirjen e tyre në rezultatin e përgjithshëm të zgjedhjeve për Kuvendin.

Në nenin 24, pika 5 të Kodit zgjedhor përcaktohet se: "Procedurat e detajuara të votimit nga jashtë vendit miratohen me akt normativ të Rregullatorit, me propozimin e Komisionerit, brenda 90 ditësh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji".

Neni 25, pika 1 dhe 12, parashikon se: Zgjedhësi që ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe që dëshiron të ushtrojë të drejtën e votës për zgjedhjet e radhës për Kuvendin duhet të regjistrohet në listën e zgjedhësve jashtë vendit, në përputhje me përcaktimet e bëra në këtë Kod dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe parashikon gjithashtu kompetencën e Komisionit Rregullator për miratimin e akteve të nevojshme normative nënligjore për përbërësit e listës së

1

  
Rruga Ibrahim Rugova Nr. 4  
Tiranë 1007, Shqipëri

cc.kqz.gov.al 

info@kqz.gov.al 



zgjedhësve jashtë vendit, dokumentacionin e nevojshëm për aplikim, mënyrën dhe afatet e komunikimit me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile dhe eventualisht bazë tjetër të dhënash, si dhe modalitetet dhe rregullat e tjera teknike të hartimit të kësaj liste.

Neni 46, pika 3 e Kodit Zgjedhor, parashikojnë se: *Lista e zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit përfshin vetëm zgjedhësit me vendbanim jashtë vendit, të cilët deklarojnë vullnetin për të ushtruar të drejtën e votimit, sipas rregullave të dala në zbatim të nenit 24 të Kodit Zgjedhor.*

## II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Komisioni Rregullator, me qëllim normimin e rregullave të regjistrimit të votuesve nga jashtë, miratoi më datë 23.10.2024 Vendimin nr 10/2024 “PER MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR REGJISTRIMIN E ZGJEDHËSVE NGA JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE PËRGATITJEN E LISTËS SË ZGJEDHËSVE”.

Qëllimi i këtij akti ishte regjistrimi gjithëpërfshirës e me akses të barabartë të zgjedhësve në listën e zgjedhësve jashtë vendit, bazuar në vullnetin e tyre të lirë për të ushtruar një të drejtë themelore kushtetuese të garantuar e të patjetërsueshme, pa dallim për të gjithë zgjedhësit tashmë, duke i dhënë mundësinë që praktikisht shtetasit shqiptarë ta ushtrorjnë të drejtën e votës edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Në përputhje me parimet e procedurat e detajuara në vendimin nr.10/2024 të KRR, rezultojnë se çdo shtetas shqiptar me të drejtë vote që ndodhet jashtë vendit në datën e zgjedhjeve dhe që dëshiron të ushtrorjë të drejtën e votës për zgjedhjet për Kuvendin nga atje ku ndodhet, duhet të regjistrohet në listën e zgjedhësve jashtë vendit.

Konkretisht, parimet themelore e thelbësore mbi të cilat duhej të ngrihej procesi i regjistrimit të shtetasve shqiptarë me banim jashtë vendit janë si vijon:

- (i) Parimi i transparencës;
- (ii) Parimi i thjeshtësisë dhe lehtësisë;
- (iii) Parimi i efektshmërisë;
- (iv) Parimi i gjithëpërfshirjes dhe aksesit të barabartë ; dhe
- (v) Parimi i diskrecionit.

Siç jeni në dijeni, nga data e miratimit të këtij akti e deri më sot, figurojnë rreth 284.643 kërkesa unike për regjistrim të zgjedhësve shqiptarë me banim jashtë vendit, nga ku rezultojnë se janë regjistruar rreth 227.259 zgjedhës unikë, si dhe janë refuzuar mbi 42.274 zgjedhës unikë.

Numri i lartë i refuzimeve në PER, padiskutim që është prova e drejtëpërdrejtë që tregon se parimet e gjithëpërfshirjes dhe lehtësisë janë dy parimet e cënuara e të pa zbatuara në thelb. Nga ana tjetër ky fakt provon dhe është tregues i qartë i keq organizimit dhe zbatimit të gabuar në praktikë nga KSHZ i vendimit të KRR nr. 10/2024.

Vetëm tre ditët e fundit janë paraqitur rreth 42.295 kërkesa për regjistrim në PER nga shtetas shqiptarë që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit, duke dëshmuar kështu një interes shumë të lartë në rritje për pjesëmarrjen në procesin zgjedhor të 11 majit 2025. Rritja e numrit të kërkesave, si dhe

interesimit ka ardhur për shkak të ndërgjegjësimit të shtetasve shqiptarë që banojnë jashtë vendit, me të drejtë vote, qoftë për shkak të fushatave ndërgjegjësuese të bëra nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, shoqëria civile dhe mediat, ashtu si edhe partitë politike të cilat gjatë kësaj kohe e kanë përqendruar aktivitetin e tyre kryesisht në diasporë.

Element tjetër i rëndësishëm për t'u konsideruar është fakti se vota e diasporës aplikohet për herë të parë në Shqipëri dhe kjo sigurisht që ka sjellë vështirësi të shtetasve shqiptarë me banim jashtë vendit për t'u njohur me këtë proces, për të kryer procedurat e regjistrimit dhe paraqitur dokumentacionin e kërkuar, cka provohet nga numri i lartë i kërkesave të refuzuara.

Në këto kushte, është e qartë se lind e nevojshme që me qëllim garantimin efektiv të së drejtës së votës, nëpërmjet zbatimit në praktikë të parimeve të gjithëpërfshirjes dhe aksesit të barabartë, lind e nevojshme dhënia e një kohe shtese për shqyrtimin qoftë të kërkesave të refuzuara, ashtu edhe kërkesave të reja që mund të bëhen nga shtetas shqiptarë me banim jashtë vendit. Kjo kohë shtesë do t'u japë mundësi të gjithë atyre shtetasve që dëshirojnë të regjistrohen dhe marrin pjesë në këtë proces të regjistrohen në PER dhe eventualisht të votojnë nëpërmjet shërbimit postar.

Prandaj, ne anëtarët e Komisionit Rregullator propozojmë një afat shtesë 5-ditor gjatë të cilit zgjedhësve që iu është refuzuar kërkesa mund të riaplikojnë, duke plotësuar dokumentacionin dhe kërkesat ligjore, si dhe për zgjedhësit e tjerë të mund të regjistrohen. Në harmoni me këtë propozim është edhe propozimi për shkurtrimin e afatit gjatë të cilit KQZ merr vendim për regjistrimin e këtyre zgjedhësve që rishprehin vullnetin e tyre për t'u regjistruar apo atyre që rishtazi kërkojnë regjistrimin.

Teknikisht ky propozim është plotësisht i realizueshëm dhe nuk krijon asnjë vështirësi përveçse iu jep mundësi bashkëkombasve tanë që të marrin pjesë në zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025. Nga ana tjetër, KQZ në përgjithësi dhe Komisioni Rregullator në vecanti dëshmon vullnetin dhe gatishmërinë e saj për të garantuar plotësisht të drejtën kushtetuese të votës për bashkëkombasit tanë që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit.

Konkretisht, propozimi ynë është si vijon:

1. Në pikën 6, të Kreut II "Rregulla të përgjithshme", togfjalëshi "...përfundon 68 ditë para kësaj date.", riformulohet si vijon: "...përfundon 63 ditë para kësaj date.".
2. Në pikën 4, të Kreut III.2 "Regjistrimi në listën e zgjedhësve", togfjalëshi "...brenda 5 ditëve...", riformulohet si vijon: "...brenda 2 ditëve...".
3. Në pikën 1, të Kreut IV "Shqyrtimi i kërkesave dhe regjistrimi i zgjedhësve nga jashtë vendit", togfjalëshi "...jo më vonë se 5 ditë...", riformulohet si vijon: "...jo më vonë se 2 ditë...".

Sa më lart në këtë relacion, si anëtarë të Komisionit Rregullator, brenda kompetencave të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, propozojmë për shqyrtim dhe miratim nga Komisioni Rregullator, projektvendimin "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 10, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, me titull **"NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 10, DATË 23.10.2024 "PËR MIRATIMIN E**

3



Rruga Ibrahim Rugova Nr. 4  
Tiranë 1007, Shqipëri



[ccc.kqz.gov.al](http://ccc.kqz.gov.al)



[info@kqz.gov.al](mailto:info@kqz.gov.al)



**RREGULLAVE PËR REGJISTRIMIN E ZGJEDHËSVE NGA JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHOIPËRISË DHE PËRGATITJEN E LISTËS SË ZGJEDHËSVE, TË NDRYSHUAR**

**ANËTARËT E KOMISIONIT RREGULATOR**

**HELGA VUKAJ**



**MUHAREM ÇAKAJ**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONI RREGULLATOR**

Data:

Nr:

Ora:

**PROJEKTVENDIM**

**PËR**

**DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 10, DATË 23.10.2024 "PËR MIRATIMIN E  
RREGULLAVE PËR REGJISTRIMIN E ZGJEDHËSVE NGA JASHTË  
TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE PËRGATITJEN E  
LISTËS SË ZGJEDHËSVE, TE NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 12, pika 4, nenit 20, pika 1, shkronja "dh", nenit 24 pika 5, nenit 25, pikat 1 dhe 12, nenit 46, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e dy anëtarëve, Komisioni Rregullator,

**V E N D O S I:**

- Në pikën 6, të Kreut II "Rregulla të përgjithshme", togfjalëshi "...përfundon 68 ditë para kësaj date.", riformulohet si vijon: "...përfundon 63 ditë para kësaj date.".
- Në pikën 4, të Kreut III.2 "Regjistrimi në listën e zgjedhësve", togfjalëshi "...brenda 5 ditëve...", riformulohet si vijon: "...brenda 2 ditëve...".
- Në pikën 1, të Kreut IV "Shqyrtimi i kërkesave dhe regjistrimi i zgjedhësve nga jashtë vendit", togfjalëshi "...jo më vonë se 5 ditë...", riformulohet si vijon "...jo më vonë se 2 ditë...".
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Ngarkohen Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, administrata e KQZ-së dhe institucionet e ngarkuara me detyra nga ky vendim për zbatimin e tij
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

**Ilirjana NANO**

**Kryetar**

**Arens ÇELA**

**Anëtar**

**Dritan ÇAKA**

**Anëtar**

**Helga VUKAJ**

**Anëtar**

**Muharrem ÇAKAJ**

**Anëtar**